



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 28 / Prot.
7

Tiranë, më 13.07.2021

V E N D I M

Nr. 34/1, datë, 13.07.2021

PËR DHËNIE MASE DISIPLINORE

Komisioni i Policisë Gjyqësore pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim oficerit të policisë gjyqësore Petrit Vukaj, dëgjoi pretendimet e tij dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

1. Mbi kërkesën e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, Shqiponja Milla, nr.4526 datë 11.06.2021, “Për procedimin disiplinor të oficerit të policisë gjyqësore të Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Shkodër, Petrit Vukaj”, protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore, me numër protokoll 28, datë 16.06.2021, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36, pika 1 e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ka nxjerrë Urdhërin nr.34, datë 25.06.2021 “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Shkodër, Petrit Vukaj, për kryerjen e shkeljeve disiplinore në formën e:

- “moskryerja, kryerja me vonesë ose ekzekutimi i pjesshëm i një urdhëri të ligjshëm të gjykatës a prokurorit, që lidhet me ushtrimin e funksioneve të Policisë Gjyqësore ”
- “kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”, parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, neni 33, pika 4, gërmat “c”, dhe “ç” të këtij ligji.

2. Nga përmbajtja e kërkesës së Prokurorit Shqiponja Milla dhe dokumentat që e shoqërojnë atë, rezulton se si bazë për fillimin e procedimit disiplinor kanë shërbyer veprimet dhe mosveprimet, në shkelje të kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale në lidhje me afatet e

hetimit, dhe ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, të kryera nga oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Vukaj. Kërkesa parashtron shkeljet e përsëritura të afateve hetimore nga oficeri i policisë gjyqësore Petrit Vukaj, kryerja e veprimeve hetimore përtej çdo afati të të përcaktuar nga Kodi i Proçedurës Penale dhe atyre të caktuara nga prokurori, si dhe sjelljet dhe qëndrimet mospërfillëse të tij ndaj kërkesave të vazhdueshme verbale dhe shkresave zyrtare të prokurorit, nëpërmjet të cilave kërkohej kthimi urgjent i procedimeve penale, deleguar këtij oficeri për kryerjen e veprimeve hetimore sipas afateve të caktuara në urdhërat përkatës të delegimit.

Nga aktet që u administruan gjatë seancës dëgjimore për proçedimin disiplinor, u provua se:

2.1 Në datën 05.02.2021 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka regjistruar proçedimin penal **nr.239/2020**, regjistruar për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal. Pas regjistrimit të proçedimit penale, në datën 05.02.2020, prokurori i çështjes ka përpiluar urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, të cilin, së bashku me fashikullin e proçedimit penal, ja ka dërguar oficerit të Policisë Gjyqësore Petrit Vukaj, me shkresën nr. 1143 Prot., datë 06.02.2020.

Për hetimin e proçedimit penal, nga prokurori është caktuar me urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore, kryerja e disa veprimeve hetimore të thjeshta. Prokurori ka caktuar datën 10.03.2020 si afat i mjaftueshëm për kryerjen e veprimeve hetimore dhe përfundimin e hetimeve. Nga aktet e dosjes, rezulton se veprimet hetimore nuk janë kryer në afatin e caktuar dhe dosja është mbajtur në dorë pa veprime nga oficeri i Policisë Gjyqësore, tej çdo afati ligjor. Kthimi i fashikullit të proçedimit penal në prokurori është bërë pas kërkesave të përsëritura të prokurorit të çështjes. Sikurse rezulton nga provat shkresore bashkalidhur kërkesës për fillimin e proçedimit disiplinor, kthimi i fashikullit nga oficeri i Policisë Gjyqësore, në prokurori është bërë në datën 24.05.2021, pas një viti dhe vetëm pasi prokurori i çështjes ka kërkuar nëpërmjet tre shkresave zyrtare, kthimin e fashikullit të hetimit.

2.2 Në datën 05.02.2020, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka regjistruar proçedimin penal nr.240/2020, për veprën penale “mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal. Pas regjistrimit të proçedimit penale, në datën 05.02.2020 prokurori i çështjes ka përpiluar urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, të cilin, së bashku me fashikullin e proçedimit penal, ja ka dërguar oficerit të Policisë Gjyqësore Petrit Vukaj, me shkresën nr.1144 Prot., datë 06.02.2020.

Në funksion të hetimit të proçedimit penal, prokurori ka caktuar kryerjen e disa veprimeve hetimore të thjeshta, sikurse janë, administrimi i aktit të ekspertimit të fishekëve, administrimi i tabelës fotografike, si dhe ripyetja e kallëzuesit. Për kryerjen e këtyre veprimeve, Prokurori ka caktuar si afat datën 10.03.2020.

Sikurse rezulton nga aktet e dosjes, veprimet hetimore nuk janë kryer në afatin e caktuar dhe dosja është mbajtur në dorë pa veprime nga oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Vukaj tej çdo afati ligjor. Kthimi i fashikullit të proçedimit penal në prokurori është bërë pas kërkesave të përsëritura të prokurorit të çështjes. Nga provat shkresore bashkalidhur kërkesës për fillimin e proçedimit disiplinor, provohet se kthimi i dosjes në prokurori është bërë pas kërimit për herë të tretë me shkresë zyrtare nga prokurori dhe pasi kishte kaluar një vit, me datë 24.05.2021. Nga aktet që ndodhen në fashikullin e proçedimit penal, rezulton fashikulli i hetimit është mbajtur në mënyrë të pajustificuar shumë gjatë, megjithëse veprimet hetimore ishin kryer

shumë kohë më parë, akti i ekspertimit është kryer që në muajin janar 2020, ripyetja e kallëzuesit është bërë në muajin Maj 2021.

2.3. Në datën 22.05.2020 është regjistruar proçedimi penal nr.714/2020, për veprën penale “Vjedhje e energjise elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal. Pas regjistrimit të proçedimit penal, në datën 11.06.2020, prokurori i çështjes ka përpiluar urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, të cilin, së bashku me fashikullin e proçedimit penal, ja ka dërguar oficerit të Policisë Gjyqësore Petrit Vukaj, me shkresën nr. 4573 Prot., datë 15.06.2020,

Në funksion të hetimit të proçedimit penal, prokurori ka caktuar kryerjen e disa veprimeve hetimore të thjeshta, sikurse janë, administrimi tabelës fotografike, marrja e informacionit me shkrim nga SPZ-ja i zonës lidhur me subjektet kontigjent të njohur në zonën në fjalë për vjedhje, verifikimin nëse ka ambjente të pajisura me kamera të jashtme sigurimi, ripyetja e të dëmtuarit. Prokurori ka caktuar datën 10.07.2020 si afat për përfundimin e hetimeve.

Sikurse rezulton nga aktet e dosjes, veprimet hetimore nuk janë kryer në afatin e caktuar dhe dosja është mbajtur në dorë nga oficeri i Policisë Gjyqësore tej çdo afati ligjor. Kthimi i fashikullit të proçedimit penal në prokurori është bërë pas kërkesave të përsëritura të prokurorit të çështjes. Nga provat shkresore bashkalidhur kërkesës për fillimin e proçedimit disiplinor, provohet se kthimi i dosjes në prokurori është bërë pas kërkimit për herë të dytë me shkresë zyrtare dhe pas kalimit të një afati afro një viti, me datë 24.05.2021.

Gjithashtu, nga aktet që ndodhen në fashikullin e proçedimit penal, rezulton se nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore nuk janë kryer veprimet hetimore të kërkuara në urdhërin e prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore, por janë kryer veprime të tjera që nuk kanë lidhje dhe interes për çështjen. Në përfundim, nga oficeri i policisë gjyqësore, sugjerohet që çështja të pezullohet.

2.4. Në datën 23.07.2021 është regjistruar proçedimi penal nr.897/2020, për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal. Pas regjistrimit të proçedimit penale, në datën 23.07.2020, prokurori i çështjes ka përpiluar urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, të cilin, së bashku me fashikullin e proçedimit penal, ja ka dërguar oficerit të Policisë Gjyqësore Petrit Vukaj, me shkresën nr. 5863, datë 23.07.2020.

Në funksion të hetimit të proçedimit penal, prokurori ka caktuar kryerjen e disa veprimeve hetimore të thjeshta, sikurse janë, administrimi tabelës fotografike, pyetja e punonjësve të OSHEE-së dhe marrja nga sistemi i të dhënave të abonentit. Prokurori ka caktuar datën 10.09.2020 si afat për përfundimin e hetimeve.

Sikurse rezulton nga aktet e dosjes, veprimet hetimore nuk janë kryer në afatin e caktuar dhe dosja është mbajtur në dorë nga oficeri i Policisë Gjyqësore tej çdo afati ligjor. Kthimi i fashikullit të proçedimit penal në prokurori është bërë pas kërkesave verbale dhe shkresore, të përsëritura të prokurorit të çështjes. Nga provat shkresore bashkalidhur kërkesës për fillimin e proçedimit disiplinor, provohet se kthimi i dosjes në prokurori është bërë pas kërkimit për të disatën herë me shkresë zyrtare dhe pas kalimit të një afati afro 10 muaj, me datë 24.05.2021.

Nga aktet që ndodhen në fashikullin e proçedimit penal rezulton se për gati 9 muaj dosja është mbajtur nga oficeri Policisë Gjyqësore pa u kryer asnjë veprim. Të gjitha veprimet hetimore të

urdhëruara nga prokurori janë kryer gjatë muajit Prill 2021. Në përfundim, oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Vukaj sugjeron dërgimin e çështjes në gjyq.

Gjithashtu, rezultoi se , procedimet penale të analizuara më lart, kanë të bëjnë me ngjarje të cilat janë referuar prej oficerit të Policisë Gjyqësore Petrit Vukaj Veprimet hetimore që janë urdhëruar për tu kryer kanë qenë veprime jo të natyrës së vështirë dhe kryerja e tyre nuk kërkonte shumë kohë.

Moskryerja e veprimeve hetimore brenda afateve të caktuara nga prokurori dhe tej afatit tre mujor të parashikuar nga neni 323 i Kodit të Procedurës Penale, ka sjellë si pasojë mosdërgimin e këtyre procedimeve në gjyq, brenda afateve ligjore.

3. Komisioni i Policisë Gjyqësore konstatoi se në të katër procedimet penale të mara në shqyrtim, sikurse rezulton nga aktet e dosjes penale, veprimet hetimore janë kryer tej afatit të caktuar në urdhërat e delegimit të prokurorit dhe tej afatit 3 mujor që parashikon neni 323 i Kodit të Procedurës Penale. Neni 323 i Kodit të Procedurës Penale parshikon se afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilin emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale.”

Komisioni konstaton se nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Petrit Vukaj, gjatë hetimit të procedimeve penale nr.239/2020, nr.240/2020, nr.714/2020 dhe nr.897/2020, janë kryer shkelje të kërkesave të Kodit të Procedurës Penale sikurse janë:

- Shkelja e kërkesave të nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se hetimet duhet të përfundojnë brenda tre muajve nga data në të cilën emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale. Madje, edhe kur prokurori ka kërkuar informacion dhe aktet e procedimeve penale nga oficeri i policisë gjyqësore, oficeri policisë gjyqësore Petrit Vukaj nuk ka reaguar, por ka vazhduar të mbajë dosjen tej këtyre afateve. Mbajtja e procedimeve penale, tej afateve ligjore ka çuar në kalimin e çdo afati ligjor të caktuar për hetimin e procedimeve penale.

- Me mosdërgimin e fashikujve të hetimit te prokurori , brenda afatit të caktuar nga prokurori dhe brenda afatit tre mujor të parashikuar nga neni 323 i Kodit të Procedurës Penale, megjithë kërkesat e vazhdueshme të tij si dhe mos informimin e prokurorit në vijimësi për ecurinë e hetimeve, ka cënuar kërkesat e Kodit të Procedurës Penale që rregullojnë mardhëniet midis oficerit të policisë gjyqësore dhe prokurorit.

Gjithashtu, Komisioni konstaton se nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Petrit Vukaj me neglizhencën e theksuar të tij, shkeljen haptazi dhe në mënyrë të përsëritur të urdhërave të ligjshëm të prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore brenda një afati të caktuar, moszbatimin haptazi të kërkesave verbale apo me shkrim për kthimin urgjent të fashikujve të procedimeve penale, të cilave, ju ka kaluar afati, duke passjellë zvarritje të afateve hetimore përtej çdo lloj afati normal dhe të arsyeshëm, janë shkelur dukshëm dhe në mënyrë të përsëritur kërkesat e Kodit të Procedurës Penale dhe nenet 5/1, gërma d, 7/1, 2, të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.

4. Në çmim të Komisionit, shkeljet e kërkesave të Kodit të Procedurës Penale lidhur me afatin e hetimeve dhe moskryerjen brenda afateve të parashikuara në ligj dhe urdhërin e delegimit të

prokurorit, të veprimeve hetimore si dhe mosinformimi në vijimësi i prokurorit për ecurinë e hetimeve, të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Petrit Vukaj, për vetë natyrën e tyre dhe pasojat që sjellin, përbëjnë shkelje disiplinore, të parashikuara nga neni 33 i ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”

- Komisioni vlerëson se shkelja e kërkesave të nenit 323 të Kodit të Proçedurës Penale, mbajtja në dorë e proçedimit penal, pa kryer veprime hetimore tej çdo afati të arsyeshëm, dhe pasojat që ka sjellë kryerja e veprimeve hetimore tej këtij afati, përbëjnë shkelje disiplinore në formën e **“zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve të oficerëve të Policisë Gjyqësore gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj”**, parashikuar nga **neni 33, pika 3, gërma “a” e ligjit 25/2019** “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Neglizhenca e theksuar e tij, shkelja haptazi dhe në mënyrë të përsëritur e urdhërave të ligjshëm të prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore brenda një afati të caktuar, moskryerja e tyre edhe pas ndërhyrjeve të prokurorit, dhe mos evidentimi i asnjë shkak apo arsye për zgjatjen e hetimeve, i bënë zvarritjet në hetimin e proçedimeve penale të pajustificuara. Ndërsa zvarritjet e lejuara në disa proçedime penale, bën që ato të konsiderohen të përsëritura, në kuptim të shkronjës “a” të pikës 3 të nenit 33 të ligjit të sipërcituar.

- Veç sa sipër, veprimet dhe mosveprimet e oficerit të Policisë Gjyqësore Petrit Vukaj, duke mosinformuar prokurorin e çështjes për ecurinë e hetimeve për gati një vit, duke mos ju përgjigjur prokurorit për kryerjen në afat të veprimeve hetimore të deleguara prej tij si dhe mosdërgimi i fashikujve të hetimit të prokurorit megjithë kërkesat e vazhdueshme të tij, përbëjnë shkelje disiplinore në formën **“mosinformimi i prokurorit për ecurinë e hetimeve nga oficeri drejtues që ka për detyrë të informojë kryesisht”**, parashikuar nga **neni 33, pika 3, gërma “ç” e ligjit 25/2019** “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

- Gjithashtu, Komisioni vlerëson se veprimet dhe mosveprimet e oficerit të policisë gjyqësore Petrit Vukaj, duke mos ju përgjigjur prokurorit dhe kërkesave të tij për informacion për ecurinë e hetimeve dhe dërgimin e fashikullit të hetimit të prokurorit i çështjes, përbëjnë shkelje disiplinore në formën **“Shkelja e rregullave të etikës”**, parashikuar nga neni 33, pika 2, gërma “c” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore. Oficerët e policisë gjyqësore, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe kërkesave për integritetin e tyre gjatë ushtrimit të detyrës, kanë detyrimin të respektojnë rregullat e komunikimit si me qytetarët ashtu dhe eprorët e tyre. Gjatë ushtrimit të detyrës ata kanë detyrimin që jo vetëm të zbatojnë me rigorozitet aktet ligjore por dhe rregullat dhe standartet etike në ndërtimin e mardhënieve me prokurorin.

Etika e oficerit të Policisë Gjyqësore në vetvete përfshin tërësinë e rregullave dhe parimeve nga të cilat ai duhet të udhëhiqet në punën e tij dhe që e ndihmojnë të përmbushë detyrimet ligjore. Në kornizën e normave dhe parimeve, një oficer i Policisë Gjyqësore është në gjendje të përmbushë me korektësi detyrimet e tij profesionale. Këtu përfshihen dhe normat etike dhe të sjelljes së oficerit të Policisë Gjyqësore, gjatë ushtrimit të detyrës së tij dhe që lidhen me detyrat konkrete që kryen ai për shkak të ushtrimit të detyrës si oficer i Policisë Gjyqësore. Normat etike të cilat kanë të bëjnë me ushtrimin e detyrës funksionale të oficerit të Policisë Gjyqësore dhe përmbushjen e rregullt të detyrës prej tij përbëhen nga tërësia e detyrave e rregullave të nevojshme për ushtrimin e funksionit të oficerit të Policisë Gjyqësore dhe që rregullohen me akte ligjore. Shtylla kryesore mbi të cilën Oficeri i Policisë Gjyqësore duhet të

mbështesë veprimtarinë e tij janë normat dhe parimet të cilat burojnë dhe janë në themel të akteve ligjore që rregullojnë veprimtarinë e Policisë Gjyqësore. Këto akte përkufizojnë standartet e etikës dhe sjelljes profesionale që duhet të zbatohen nga oficeri i Policisë Gjyqësore. Shkelja e këtyre akteve krijon bazën për sanksione siç parashikohet në Ligjin Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Rregullat e parashikuara në këto akte ligjore, përcaktojnë parimet, normat dhe udhëzimet e etikës dhe sjelljes së oficerëve të Policisë Gjyqësore gjatë ushtrimit të detyrës, për të siguruar dhe garantuar profesionalizëm, pavarësi, paanshmëri, ndershmëri, integritet dhe korektësi në ushtrimin e funksioneve të tyre, për të përmirësuar dhe rritur mardhëniet institucionale me subjektet e tjera të procedimit penal. E gjitha kjo, në interes të zbatimit të standarteve të larta të sjelljes profesionale të oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe në interes të drejtësisë penale dhe rritjes së besimit të publikut te Policia Gjyqësore.

Në këtë këndvështrim, parashikimet e bëra në nenin 7, të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, ku përcaktohet se “Oficeri i policisë gjyqësore, ushtron funksionet e tij për hetimin e çështjes konkrete nën varësinë e prokurorit dhe drejtohet e kontrollohet prej tij. Ai zbaton urdhërat dhe udhëzimet e prokurorit për kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve” dhe parashikimi i nenit 5, pika 1, shkronja “d”, të këtij ligji, ku përcaktohet se “ oficeri i Policisë Gjyqësore kryen çdo veprim të urdhëruar ose të deleguar nga prokurori”, përbëjnë norma të etikës dhe sjelljes së oficerit të Policisë Gjyqësore, gjatë ushtrimit të detyrës. Rjedhimisht moszbatimi i këtyre normave etike apo shkelja e tyre sjell përgjegjësi disiplinore për shkelësin e tyre.

4.1 Lidhur me shkeljet disiplinore të parashtruara në kërkesën e prokurorit Shqiponja Milla dhe në Urdhërin për fillimin e procedimit disiplinor, - “moskryerja, kryerja me vonesë ose ekzekutimi i pjesshëm i një urdhëri të ligjshëm të gjykatës a prokurorit, që lidhet me ushtrimin e funksioneve të Policisë Gjyqësore dhe “kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Procedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”, të parashikuara si shkelje disiplinore nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, neni 33, pika 4, gërmat “c”, dhe “ç” Komisioni arrin në konkluzionin se këto shkelje nuk janë kryer nga oficeri i policisë gjyqësore Petrit Vukaj.

4.2 Për konsumimin e shkeljes të parashikuara në nenin 33, pika 4, germa “c” e ligjit 25/2019, “moskryerja, kryerja me vonesë ose ekzekutimi i pjesshëm i një urdhëri të ligjshëm të gjykatës a prokurorit, që lidhet me ushtrimin e funksioneve të Policisë Gjyqësore”, Komisioni nisur nga leximi dhe interpretimi i këtij neni të ligjit, arrin në përfundimin se kjo shkelje nuk është kryer. Me termin urdhër i ligjshëm i gjykatës a prokurorit, ligjvënësi ka parasysh një akt, (vendim, urdhër) të gjykatës apo të prokurorit, të cilat sjellin pasoja të drejtpërdrejta mbi palët në proces. Të tilla mund të jenë, vendimi për caktim mase sigurimi, urdhër ekzekutimi i vendimit penal, vendim sekuestro, etj. Urdhëri i prokurorit me të cilin urdhëron oficerin e policisë gjyqësore për kryerjen e veprimeve konkrete hetimore, nuk mund të konsiderohet i asaj natyre, moszbatimi në kohë i të cilit, sjellë përgjegjësi disiplinore sipas kësaj pike dhe shkronje të nenit 33 të ligjit 25/2019.

4.3 Lidhur me parashtrimin për kryerjen e shkeljes disiplinore në formën “kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të

Procedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”, të parashikuara si shkelje disiplinore nga ligji nr.25/2019 , neni 33, pika 4, gërma ”ç”, konstatohet se nga veprimet e oficerit të Policisë Gjyqësore Petrit Vukaj lidhur me mbajtjen në dorë të procedimeve penale për një kohë të gjatë dhe pa shkaqe të përligjura , mosrespektimi i afateve për kryerjen e veprimeve hetimore të caktuara nga prokurori, mosdërgimi i dosjeve në kohë të prokurori, janë shkelur kërkesat dhe rregullat e vendosura nga Kodi i Procedurës Penale për afatet e hetimit. Por këto veprime dhe mosveprime të tij, në shkelje të kërkesave të Kodit të Procedurës Penale, për vetë natyrën e tyre ligjvënësi i ka kategorizuar si shkelje disiplinore në formën e zvarritjeve në hetim. Fakti që këto shkelje nuk kanë sjellë pasoja të riparueshme për hetimin e çështjes, nuk mund të ngrihet në nivelin e shkeljes disiplinore, të parashikuar nga germa “ç” e pikës 4 të nenit 33 të ligjit 25/2019 dhe të klasifikohet si shkelje shumë e rëndë në kuptim të ligjit.

5. Në përfundim, në analizë dhe vlerësim të akteve të administruar gjatë shqyrtimit të procesit disiplinor, përfshirë dhe sqarimet dhe shpjegimet e subjektit të procedimit disiplinor, Komisioni i Policisë Gjyqësore, arrin në përfundimin se, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Petrit Vukaj , me veprimet dhe mosveprimet e tij, gjatë hetimit të procedimeve penale nr.239/2020, nr.240/2020, nr.714/2020 dhe nr.897/2020, janë kryer shkeljet disiplinore në formën:

- **“zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve të oficerëve të Policisë Gjyqësore gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj”**, parashikuar nga **neni 33, pika 3, gërma “a” e ligjit 25/2019** “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

- **“mosinformimi i prokurorit për ecurinë e hetimeve nga oficeri drejtues që ka për detyrë të informojë kryesisht”**, parashikuar nga **neni 33, pika 3, gërma “ç” e ligjit 25/2019** “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

- **“shlelja e rregullave të etikës**, parashikuar nga **neni 33, pika 2, gërma “c” e ligjit 25/2019** “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Lidhur me këto shkelje, Oficeri i Policisë Gjyqësore, Petrit Vukaj shpjegon se, nuk i ka kryer ato dhe se vonesat kanë ardhur për shkak të ngarkesës në punë. Sipas shpjegimeve të tij, në veprimtarinë e përditshme, ka kryer dhe detyra të tjera, pjesë e funksioneve të Policisë, së Shtetit.

Shpjegoimet dhe pretendimet e oficerit të policisë gjyqësore Petrit Vukaj , nuk justifikojnë shkeljet e kryera dhe vonesat në hetimin e procedimit penal. Ngarkesa në punë që oficeri i policisë gjyqësore ka përballuar gjatë përfshirjes së tij në aktivitete të tjera të punës policore, nuk mund të justifikojnë zvarritjet dhe mosplotësimin e detyrimeve ligjore gjatë hetimit të procedimeve penale. Referuar ligjit nr.25/2019 “Për funksionimin dhe organizimin e Policisë Gjyqësore”, nenet 2, pika 6 dhe neni 4, gërma “b”, oficerët e policisë gjyqësore të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit, të ngarkuar posaçërisht me kryerjen e hetimeve, kanë detyrimin ligjor për marrjen e masave për respektimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit që rregullojnë dhe dispiplinojnë oficerët e policisë gjyqësore për hetimin e veprave penale.

6.. Duke i konsideruar të provuara shkeljet disiplinore të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Petrit Vukaj, Komisioni, për caktimin e llojit të masës disiplinore ndaj tij, i referohet ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Ligji i sipërcituar, në nenin 33, i klasifikon shkeljet disiplinore të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore në tre kategori:

- a) Të lehta;
- b) Të rënda;
- c) Shumë të rënda.

Po ky ligj, në gërmën “c” pika 2 e nenit 33 të ligjit, parashikon si **shkelje të lehtë** “ *shkelja e rregullave të etikës*”.

Ndërsa në pikën 3 të këtij neni, në gërmat “a” dhe “ç”, parashikon si **shkelje të rënda** , “*zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve të oficerëve të Policisë Gjyqësore gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj*”, dhe “ *mosinformimi i prokurorit për ecurinë e hetimeve nga oficeri drejtues që ka për detyrë të informojë kryesisht* ”

Për caktimin e masës disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore, Petrit Vukaj , Komisioni merr në konsideratë llojin dhe natyrën e shkeljeve disiplinore të kryera prej tij, pasojat që ato kanë sjellë, rrethanat e dala gjatë shqyrtimit lidhur me ngarkesën në punë dhe personalitetin e tij. Komisioni merr parasysh faktin që gjatë vitit 2020 ka përballuar një volum të konsiderueshëm pune .

Gjithashtu Komisioni i referohet parashikimeve të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” për parashikimet që ai bën për masat disiplinore, në raport me shkeljen e kryer.

Ligji i sipërcituar, në nenin 34 në pikën 1, parashikon llojet e masave disiplinore duke i klasifikuar sipas radhës, **a) vërejtje me shkrim, b) vërejtje me paralajmërim, c) ulje në detyrë me afat nga tre muaj deri në në vit, ç) pezullim nga detyra deri në 6 muaj dhe d) largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të.**

Në pikën 2 të nenit 34 parashikohet që për shkeljet e lehta jepen masat disiplinore “vërejtje me shkrim” ose “vërejtje me paralajmërim”.

Ndërsa, në pikën 3 të nenit 34, parashikohet që për shkeljet e rënda, jepet masa disiplinore “ulje në detyrë me afat nga tre muaj deri në në vit”

Gjithashtu, Komisioni konstaton se në rastin objekt shqyrtimi, janë konsumuar tre shkelje disiplinore nga oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Vukaj, nga të cilat, njëriën ligji 25/2019 e klasifikon shkelje të lehtë dhe dy të tjerat të rënda. Në raste të tilla, kur ka konkurim të shkeljeve disiplinore dhe shkeljeve të konstatuara u përkojnë masa të ndryshme disiplinore, bazuar në nenin 1, pikat 5 dhe 6 të Rregullores nr.1, datë 21.04.2020 “Për procedimin disiplinor”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, Komisioni duhet të japë një masë të vetme disiplinore, masën më të rëndë.

Referuar dispozitave ligjore të sipërpërmendura dhe shkeljeve konkrete të kryera, Komisioni çmon që ndaj oficerit të policisë gjyqësore Petrit Vukaj të japë masën disiplinore “ **ulje në**

detyrë me afat një vit”, parashikuar nga neni 34, pika 1, gërma “c” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.

Për sa më sipër, në bazë të neneve 10, shkronja “ç”,11, pika 4, nenit 33, pika 2, gërma “a”, pika 3, gërmat “a” dhe “ç”, neni 34, pika 1, gërma “c”, pika 3 dhe neni 38 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Komisioni i Policisë Gjyqësore, me 9 vota pro,

V E N D O S I:

1. Oficerit të policisë gjyqësore Petrit Vukaj , me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Komisarriatin e Policisë Shkodër, i jepet masa disiplinore “ *Ulje në detyrë me afat një vit*”.
2. Me këtë vendim , të njihet oficeri i policisë gjyqësore Petrit Vukaj , i cili, në bazë të nenit 39 të ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative.
3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, Shqiponja Milla.
4. Vendimi të administrohet në dosjen personale të oficerit të policisë gjyqësore Petrit Vukaj.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI



ANËTAR

ARJAN MUÇA

ANËTAR

HARI GOGO

Mungon.

ANËTAR

ARTUR SEJATI

ANËTAR

ALBERT MUÇO